

V E N D I M
I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME
TE ORTAKEVE
Date 5 Korrik 2002



Shoqeria "EURO GREN" Shpk, e regjistruar ne Regjistrin Tregetar me vendimin Nr. 11574, date 14.02.1995 te Gjykates se Rrethit Tirane, me seli te regjistruar ne Tirane, me ortak: shoqeria Verugia Shpk., zoteruese e 71% te pjeseve te kapitalit te shoqerise dhe shteti shqiptar, zoterues i 29% te pjeseve te kapitalit te shoqerise, sot me date 05.07.2002 mbajti mbledhjen e saj te jashtezakonshme me rendin e dites si me poshte:

- Transferimi i pjeseve te kapitalit te zoteruara nga ortaku, shoqeria Verugia Shpk;
- Te ndryshme.

Te pranishem ne mbledhje:

Ortaku: Shoqeria Verugia Shpk., perfaqesuar nga Administratori i saj Z. Saverio Iandiorio;

Ortaku: Shteti shqiptar, perfaqesuar nga Znj. Marie Beqiri.

Pas diskutimit te pikave te rendit te dites, Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve te shoqerise "EURO GREN" Shpk.

V e n d o s i:

"Ortaku, Verugia Shpk. mund te shese lirisht pjeset e veta ne kapitalin e shoqerise. Shteti shqiptar heq dore nga e drejta e parablerjes se pjeseve te kapitalit te shoqerise te zoteruara nga ortaku, shoqeria Verugia Shpk. dhe pranon qe pjeset e zoteruara prej tij t'u transferohen lirisht te treteve".

Tirane, 05. 07. 2002

ORTAKET

VERUGIA Shpk

Perkthyes:

Alteta Uhusi

Shteti shqiptar

Marie Beqiri



V E N D I M
I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME
TE ORTAKEVE

Date 6.11 2002

Shoqeria "EURO GREN" Shpk, e regjistruar ne Regjistrin Tregëtar me vendimin Nr. 11574, date 14.02.1995 te Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane, me seli te regjistruar ne Tirane, me ortake: shoqeria Verugia Shpk., zoteruese e 71% te pjeseve te kapitalit te shoqerise dhe shteti shqiptar, zoterues i 29% te pjeseve te kapitalit te shoqerise, sot me date 29.10.2002 mbajti mbledhjen e saj te jashtezakonshme me rendin e dites si me poshte:

1. Miratimi i Kontrates se shitjes (transferimit) te pjeseve te kapitalit te shoqerise "EURO GREN" Shpk. te zoteruara nga Ortaku, shoqeria Verugia Shpk. te Bleresat Z. Hasan Hafizi, Z. Edmond Mersini dhe Znj. Mirela Mula;
2. Ndryshimi i statutit te shoqerise "EURO GREN" Shpk. si rrjedhoje e transferimit te pjeseve te kapitalit te shoqerise duke pasqyruar pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerise te ortakeve te rinj.
3. Te ndryshme.

Te pranishem ne mbledhje:

Ortaku: Shoqeria Verugia Shpk., perfaqesuar nga Administratori i saj Z. Saverio Iandiorio;

Ortaku: Shteti shqiptar, perfaqesuar nga Znj. Marie Beqiri.

Pas diskutimit te pikave te rendit te dites, Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve te shoqerise "EURO GREN" Shpk.

V e n d o s i:

1. Miratohet Marreveshja e shitjes (transferimit) te pjeseve te kapitalit te shoqerise "EURO GREN" Shpk. te zoteruara nga ortaku, shoqeria Verugia Shpk. te Bleresat Z. Hasan Hafizi, Z. Edmond Mersini dhe Znj. Mirela Mula nenshkruar me date 26.07.2002, nr. 7683 rep, nr. 1036 kol..
2. Te ndryshohet statuti i shoqerise "EURO GREN" Shpk. si rrjedhoje e transferimit te pjeseve te kapitalit te shoqerise duke pasqyruar pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerise te ortakeve te rinj:

Pjesa hyrese e Statutit te shoqerise ndryshohet si me poshte vijon:

"Kapitali i shoqerise "EURO GREN" zoterohet prej ortakeve si me poshte vijon:



Ortaku, shteti shqiptar zoteron 29% te kapitalit te shoqerise;
 Ortaku, Z. Hasan Hafizi zoteron 23.66% te kapitalit te shoqerise;
 Ortaku, Z. Edmond Mersini zoteron 23.66% te kapitalit te shoqerise;
 Ortaku Znj. Mirela Mula, zoteron 23.66% te kapitalit te shoqerise”.

Tirane, _____. 2002

ORTAKET

VERUGIA Shpk.

SHTETI SHQIPTAR

[Handwritten signature]

Marie Beqiri
[Handwritten signature]

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
 DHOMA E NOTEREVE TIRANE**

Nr. 10747 Rep.

Nr. 1456 Kol.

VERTETIM

Ne Tirane, sot me 06.11.2002, perpara meje Noterit te Dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten personalisht Z. Edmond Mersini, shtetas shqiptar, lindur me 23.02.1961, banues ne adresen : Rr. Margarita Tutulani, Pall 8/2, Tirane, mbajtes i pasaportes nr. 1114352, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i autorizuar me prokure te posaçme date 26.10.2002 nga Z. Saverio Iandiorio shtetas italian, lindur me 09.01.1952, mbajtes i pasaportes nr. 819042U dhe Znj. Marie Beqiri, lindur me 10.05.1952, banuese ne Tirane, Rr. Ali Visha, Nr. 13, mbajtese e kartes se identitetit nr. 3131151, per identitetin e te cileve u sigurova nga dokumentat identifikues qe me paraqiten, persona madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Pasi une Noteri, e lexova dhe e shpjegova aktin bashkengjitur ketij vertetimi, ata me deklaruan se e kuptojne, e pranojne dhe se e kane hartuar ate ne perputhje te plote me vullnetin e tyre te lire, dhe e nenshkruajne rregullisht ne pranine time, gjete cilen une Noteri e vertetoj sipas ligjit.



NOTER

Robo
[Handwritten signature]

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM
-PER DEPOZITIMIN E AKTEVE TE PERSONIT JURIDIK-

Sot me 14/11.2002, une G. X..., Gjyqtare prane Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur per depozitimin ne Regjistrin Tregtar te vendimeve te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise "EURO GREN" Shpk. si dhe te Marreveshjes se Transferimit te Kuotave te dates 26.07.2002, si dhe dokumentat perkates nga te cilet:

KONSTATOVA

Shoqeria "EURO GREN" Sh.p.k. eshte regjistruar si person juridik ne regjistrin tregtar, me vendimin nr.11574, date 14.02.1995 te Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane.

Me date 05.07.2002 eshte thirrur dhe mbledhur Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve te shoqerise "EURO GREN" Shpk. e cila ka vendosur:

"Ortaku, Verugia Shpk. mund te shese lirisht pjeset e veta ne kapitalin e shoqerise. Shteti shqiptar heq dore nga e drejta e parablerjes se pjeseve te kapitalit te shoqerise te zoteruara nga ortaku, shoqeria Verugia Shpk. dhe pranon qe pjeset e zoteruara prej tij t'u transferohen lirisht te treteve".

Me date 06.11.2002 eshte thirrur dhe mbledhur Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve te shoqerise "EURO GREN" Shpk. e cila ka vendosur:

1. Te miratohet Marreveshja e shitjes (transferimit) te pjeseve te kapitalit te shoqerise "EURO GREN" Shpk. te zoteruara nga ortaku, shoqeria Verugia Shpk. te Bleresat Z. Hasan Hafizi, Z. Edmond Mersini dhe Znj. Mirela Mula.
2. Te ndryshohet statuti i shoqerise "EURO GREN" Shpk. si rrjedhoje e transferimit te pjeseve te kapitalit te shoqerise duke pasqyruar pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerise te ortakeve te rinj:

Rrjedhimisht, pjesa hyrese e Statutit te shoqerise ndryshohet si me poshte vijon:

"Kapitali i shoqerise "EURO GREN" prej 51.760.627 Leke eshte i ndare mes ortakeve si me poshte vijon:

- Ortaku, shteti shqiptar zoteron 29% te kapitalit te shoqerise;
- Ortaku, Z. Hasan Hafizi zoteron 23.66% te kapitalit te shoqerise;
- Ortaku, Z. Edmond Mersini zoteron 23.68% te kapitalit te shoqerise;
- Ortaku Znj. Mirela Mula, zoteron 23.66% te kapitalit te shoqerise".

Gjithashtu konstatova qe kerkesa per depozitimin ne Regjistrin Tregtar te vendimeve te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise "EURO GREN" Shpk. te dates 05.07.2002 dhe 06.11.2002 si dhe te Kontrates se Transferimit te Kuotave te dates 26.07.2002, eshte e bazuar ne ligj, dhe


PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi Shoqerite Tregtare" dhe te ligjit nr. 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitete qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare",

VENDOSA

- Pranimin e kerkeses.
- Depozitimim e vendimeve te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise "EURO GREN" Shpk. te dates 05.07.2002 dhe 06.11.2002 si dhe te Marreveshjes se Shitjes (transferimit) te Kuotave te dates 26.07.2002, me nr. 7683 rep dhe nr. 1036 kol.
- Urdherohet zyra e Regjistrin Tregtar te beje ndryshimet perkatese ne kollonen *Cap*, germa __ si dhe te behet ndarja nga njeri-tjetri me vize te kuqe.

GJYQTARE



MARREVESHJE
PER TRANSFERIMIN E PJESEVE TE KAPITALIT TE
SHOQERISE "EURO GREN" SHPK



Sot ne Tirane me date 26.07.2002, perpara meje noterit te Dhomes se Notereve Tirane, Agim Robo, u paraqiten palet e meposhtme:

SHITESI: **Shoqeria Verugia Shpk.**, regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me vendimin nr. 5310, date 06.07.1994, perfaqesuar nga Administratori, Z. Saverio Iandiorio, shtetas italian, lindur me 09.01.1952, mbajtes i pasaportes nr. 819042U, banues ne Avellino, Itali, me zotesi te plote juridike per te vepruar;

Dhe

BLERESIT: **Z. Hasan Hafizi**, shtetas shqiptar, lindur ne Lezhe, me 11.02.1955, mbajtes i pasaportes nr. 0121999, banues ne Tirane me zotesi te plote juridike per te vepruar;

Z. Edmond Mersini, shtetas shqiptar, lindur me 23.02.1961, banues ne adresen : Rr. Margarita Tutulani, Pall 8/2, Tirane, mbajtes i pasaportes nr. 1114352, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar ;

Znj. Mirela Mula, shtetase shqiptare, lindur me 21.09.1967, mbajttese e leternjoftimit nr. NF 087995, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar.

MEQENESE

- a) Shitesi zoteron 71% te kapitalit te Shoqerise "EURO GREN" Shpk. dhe deshiron te shese te gjithë pjeset e tij ne kapitalin e Shoqerise;
- b) Bleresit deshirojne te blejne, ne pjese te barabarta pjeset e kapitalit te Shoqerise "EURO GREN" Shpk te zoteruara nga Shitesi;
- c) Pjeset e kapitalit shiten (transferohen) me nje vlere nominale prej 36.800.000 (tridhete e gjashte milion teteqind mije) Leke.
- d) Shteti shqiptar ne cilesine e ortakut te shoqerise "EURO GREN" Shpk. i cili zoteron 29% te kapitalit te shoqerise ka hequr dore nga e drejta e parablerjes se kuotave te ofruara per shitje.

Palet bien dakort per sa me poshte vijon:

1. Objekti i Marreveshjes

- 1.1 Sipas kushteve te parashikuara ne kete Marreveshje, Shitesi bie dakord te transferoje tek Bleresit dhe keta te fundit bien dakord te blejne 71% te pjeseve te kapitalit te shoqerise "EURO GREN" Shpk te zoteruara nga Shitesi ne kete shoqeri;
- 1.2 Shitesi zoterues i 71% te pjeseve te kapitalit te shoqerise "EURO GREN" Shpk. i shet (transferon) Bleresve pjeset e kapitalit qe ai zoteron ne shoqerine "EURO GREN" si me poshte:
 - Z. Hasan Hafizi i transferohen 23.66% e pjeseve te kapitalit themeltar;
 - Z. Edmond Mersini i transferohen 23.66% e pjeseve te kapitalit themeltar;
 - Znj. Mirela Mula i transferohen 23.66% e pjeseve te kapitalit themeltar;
- 1.3 Bleresit deklarojne dhe i pranojne pjeset pa asnje pretendim te tashem apo te ardhshem mbi to.

2. Çmimi i shitjes

- 2.1 Pjeset e kapitalit, objekt i kesaj Marreveshje shiten (transferohen) kundrejt nje vlere prej EURO 220.000 (dyqind e njezetmije), vlere per te cilen Bleresit nuk kane asnje pretendim.

3. Pagesa e çmimit te shitjes

- 3.1 Bleresit deklarojne se kane paguar te gjithë çmimin e shitjes se 71% te pjeseve te kapitalit te shoqerise "EURO GREN" Shpk. te percaktuar ne nenin 2 me siper, perpara nenshkrimt te kesaj Marreveshje dhe Shitesi deklarone se e ka marre çmimin e shitjes dhe nuk ka asnje pretendim te tashem apo te ardhshem lidhur me pagesen e çmimit te shitjes.

4. Garancite


- 4.1 Shitesi garaton se pjeset e kapitalit qe i shet (transferon) Bleresve jane te lira nga çdo barre apo pretendim tjeter ligjor i te treteve mbi to.
- 4.2 Bleresit i garantojne Shitesit se pranon dispozitat e parashikuara ne statutin e shoqerise "EURO GREN" Shpk dhe garanton respektimin e plote te tyre.

5. Te ndryshme

- 5.1 Pas shitjes (transferimit) te pjeseve te kapitalit tek Bleresi, kapitali i shoqerise "EURO GREN" Shpk ndahet si me poshte vijon:

- 5.1.1 Shteti shqiptar eshte zoterues i 29% te pjeseve te kapitalit te shoqerise;
- 5.1.2 Z. Hasan Hafizi eshte zoterues i 23.66% te pjeseve te kapitalit te shoqerise;
- 5.1.3 Z. Edmond Mersini eshte zoterues i 23.66% te pjeseve te kapitalit te shoqerise;
- 5.1.4 Znj. Mirela Mulo eshte zoterues i 23.66% te pjeseve te kapitalit te shoqerise;

- 5.2 Shoqeria "EURO GREN" Shpk dhe administratori i saj do te kryejne te gjitha veprimet e nevojshme per regjistrimin ne Regjistrin Tregtar Shqiptar te kesaj Marreveshje per shitjen e pjeseve te kapitalit.



Ne momentin e nenshkrimt te kesaj Marreveshje, Shitesi humbet çdo te drejte pronesie, per ndarje dividendi, per drejtimin e shoqerise dhe çdo te drejte tjeter qe rrjedh nga zoterimi i pjeseve te kapitalit te Shoqerise dhe Bleresit behen pronare te ligjshem te pjeses se tyre ne kapitalin e Shoqerise.

6. Baza E gjore

Kjo marreveshje do te interpretohet dhe zbatohet ne perputhje me dispozitat e Kodit Civil te Republikes se Shqiperise dhe te ligjit nr. 7638 date 19.12.1992 "Mbi shoqerite tregtare"

Kjo marreveshje hartohet ne 5 (pese) kopje, nje kopje per zyren e regjistrimit te shoqerive tregtare, nje kopje per t'u depozituar tek noteri dhe nje kopje per secilen nga palet.

Kjo marreveshje pasi u lexua ne prani te noterit, me ndihmen e perkthyesit _____, u gjet ne perputhje me vullnetin e lire e te plote te paleve dhe u nenshkrua rregullisht prej tyre ne pranine time dhe une Noteri e vertetoj kete marreveshje sipas ligjit.

SHITESI

Saverio Landi
SAVERIO-LANDI

BLERESI

Mirjeta Mule
Mule


Perkthyes:

Alketa Ursic
[Signature]

Edmond Mermiri

NOTERI

[Signature]
Haseu Hafizi
[Signature]



VENDIM

I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE ORTAKEVE , Date 01.09.2014

Shoqeria "EUROGREN" shpk, e regjistruar ne Regjistrin Tregetar me vendim Nr. 11574, date 14.02.1995 te gjykates se Shkalles se pare Tirane , me seli ne Tirane ne adresen Rr. "Konferanca e Pezes", Nd 73. H1. 1027 TIRANE, me NIPT J61814077J, sot me daten 01.09.2014 mbajti mbledhjen e asamblese se pergjithshme te ortakeve me rendin e dites si me poshte:

1. Fillimi i procedures se Privatizimit te kuotave shtetore ne Eurogren"shpk Tirane.
2. Miratimi i eksperteve per vleresimin e kuotave shtetore te shoqerise.

Te pranishem ne mbledhje:

Ortaku: shteti shqiptar perfaqsuar nga Zj. Gjinovefa Arizaj 29 %. Ortaku: Zj Mirela MULA, 23.66%. Ortaku: z. Hasan HAFIZI, 23.66 %. Ortaku: z. Edmond MERSINI, 23.68%.

Pas diskutimit te pikave te rendit te dites asambleja e pergjithshme e ortakeve te shoqerise "EUROGREN"shpk . VENDOSI :

1. Miratimin e fillimit te procedures se privatizimit te kuotave shtetore ne "EUROGREN"shpk Tirane, sipas VKM-se Nr 777. Date 11.10.2006 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne VKM-ne Nr 230. Date 4.4.2008"Per privatizimin e pjeseve te kapitalit te zoteruara nga Shteti"
2. Caktimin e eksperteve per vleresimin e kuotave te shtetore te shoqerise :

Zj. Ludmilla PALUKA, Eksperte Kontabel e Autorizuar.

Zj Vullnetare Cela, Eksperte vleresuse.

ORTAKET

Zj. Gjinovefa Arizaj. Zj. Mirela Mula. Z. Hasan Hafizi. Z. Edmond Mersini

Gjinovefa Arizaj
[Signature]

Mirela Mula
[Signature]

Hasan Hafizi
[Signature]

Edmond Mersini
[Signature]